



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.03.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i vendimeve nr. 41 dhe 45, dt. 11.3.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, të Shqipërisë në qarqet Berat dhe Tiranë për plotësimin e vakancave të njoftuara nga Kuvendi i Shqipërisë si dhe verifikimi i mandatit të deputetëve z. Lefter Maliqi dhe znj. Majlinda Halilaj.

2. Shqyrtimi i vendimeve nr. 42, nr. 43 dhe 44, dt. 11.3.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, të Shqipërisë në qarqet Lezhë, Durrës dhe Gjirokastrë për plotësimin e vakancave të njoftuara nga Kuvendi i Shqipërisë si dhe verifikimi i mandatit të deputetëve znj. Elda Hoti dhe znj. Edlira Hyseni dhe znj. Ediola Braha.

Marrin pjesë:

Gramoz Ruçi, Vasilika Hysi, Klotilda Bushka, Ulsi Manja, Damian Gjikhuri

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi – Fillojmë mbledhjen e sotme të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin.

Nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve janë depozituar në Kuvend vendimet për dhënien e mandatit të deputetëve të kandidatëve të listës shumëëmërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, në qarqet Lezhë, Durrës dhe Gjirokastrë, si dhe të Partisë Demokratike në qarqet Berat dhe Tiranë.

Në mbështetje të nenit 13 të Rregullores, Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin mbledhet për të bërë verifikimin e mandatit të deputetit që zgjidhet gjatë legjislaturës. Këtë mbledhje të posaçme e zhvillojmë sot për secilin prej kandidatëve që kanë fituar mandatin e deputetit, konkretisht:

- z. Lefter Maliqi shpallur deputet i Kuvendit të Shqipërisë, vendimi nr. 41, dt. 11.3.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,

- znj. Elda Hoti shpallur deputete e Kuvendit të Shqipërisë me vendim nr. 42, dt. 11.3.2019, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,

- znj. Edlira Hyseni shpallur deputete e Kuvendit të Shqipërisë me vendim nr. 43, dt. 11.3.2019 të Komisionit Qendror i Zgjedhjeve,

- znj. Ediola Braha shpallur deputete e Kuvendit të Shqipërisë me vendim nr. 44, dt. 11.3.2019 të Komisionit Qendror i Zgjedhjeve dhe

- znj. Majlinda Halilaj shpallur deputete e Kuvendit të Shqipërisë me vendim nr. 45, dt. 11.3.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Siç jeni në dijeni, si rezultat i dorëheqjeve të deputetëve të opozitës, nga mandati i deputetit, mbështetur në nenin nr. 164 të Kodit Zgjedhor, Kuvendi i është drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të njoftuar për vakancat e krijuara. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimet, nr. 41, nr. 42, nr. 43, nr. 44 dhe nr. 45 i ka dhënë mandatin deputetëve vijues të listave respektive. Vendimet i keni të gjithë përpara.

Në mbështetje të nenit 13, pika 5 të Rregullores, Këshilli për Rregulloren dhe Imunitetin verifikon mandatin e deputetit, i cili zgjidhet gjatë legjislaturës dhe paraqet raportin përkatës në seancë plenare brenda 30 ditëve. A ka ndonjë mendim, ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim nga anëtarët e Këshillit, në lidhje me mandatin e deputetëve të ri?

Nuk ka.

Atëherë, jemi dakord!

Anëtarët e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin janë dakord me vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Të bëhet gati edhe raporti. T'u shpërndahet deputetëve nesër në seancë!

Znj. Klotilda Bushka ta paraqesë në seancë raportin, siç është rregulli, i cili shpreh këtë qëndrim të Këshillit, i cili do të votohet nga seanca.

Të njoftohen të 5 kandidatët që nesër në orën 10:00 të jenë në seancë plenare.

Mirupafshim!

Mbledhja mbyllet.

MBYLLET MBLEDHJA